


RAPORT

MBROJTJA E FËMIJËVE


Maj 2021



Raport

Mbrojtja e fëmijëve


Ky raport u mundësua në kuadër të projektit "Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë" i cili implementohet nga HANDIKOS në partneritet me Save dhe Children in Kosovo, dhe financohet nga "Swedish International Development Cooperation Agency (SIDA)". Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e HANDIKOS dhe nuk pasqyron me doemos pikëpamjet e donatorit.



FALENDERIME!


HANDIKOS falenderon të gjithë institucionet në nivel qendror dhe lokal si dhe të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët e ngushtë në katër komunat e targetuara, të cilët gjatë pesë viteve të implementimit të këtij projekti, ofruan mbështetje dhe kontribuan për mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe arritjen e rezultateve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Po ashtu HANDIKOS falenderon të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre, zyrtarët dhe profesionistët që kontribuan në hartimin e këtij raporti, i cili synon të përmbledhë rezultatet e arritura në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe në të njëjtën kohë të pasqyrojë impaktin e HANDIKOS në mbrojtjen e fëmijëve, përgjatë 5 viteve të implementimit të projektit “Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë”.



PËRMBAJTJA

Shkurtesat	9
Përmbledhje ekzekutive	10
I. Hyrje	16
Qëllimi i vlerësimit	21
Objektivat	22
Analiza e të dhënave teorike	22
Intervistat	23
Analiza e të dhënave të përfituara	23
II. Metodologjia	24
III. Gjetjet kryesore të vlerësimit	30
Rezultatet	31
Impakti	34
Qëndrueshmëria	38
IV. Përfundime dhe rekomandime	40
V. Shtojcat	44
Lista e të intervistuarve	46
Pyetësorët	47



SHKURTESAT

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
HANDIKOS	Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës
IMF	Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
LPMFFAKP	Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme
MD	Ministria e Drejtësisë
MICS	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
PMF	Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
QK	Qeveria e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRBB	Qendrat e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

”



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë” i cili ka nisur të implementohet në 2017, është projekt 5 vjeçar i financuar nga SIDA dhe i implementuar nga HANDIKOS në partneritet me Save the Children zyra në Kosovë. Ai ka si qëllim të përgjithshëm të kontribuojë në ndërtimin e një ambienti më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Projekti ka dy objektiva specifike të cilët janë:

- Përmirësimi i cilësisë së politikave dhe praktikave të sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe rritja e vetëdijes dhe bashkëveprimit ndër-sektorial ndërmjet komunitetit dhe ofruesve të shërbimeve për të parandaluar dhe përgjigjur rasteve të dhunës në të gjitha mjediset në Kosovë;
- Promovimi i llogaridhënies sociale me fokus tek fëmijët si dhe pjesëmarrjes së fëmijëve për përmirësimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ofrimin e shërbimeve profesionale dhe adekuate për ta.

Ky raport vlerëson dhe përmbledh të arriturat kryesore të implementimit të projektit në raport me objektivin e parë të ndërlidhur me fushën e mbrojtjes së fëmijëve si dhe ofron rekomandimet përkatëse drejt vijimësisë së rezultateve të arritura dhe qëndrueshmërisë së tyre edhe pas përfundimit të projektit.

Në tërësi projekti i ka arritur objektivat dhe qëllimin e paracaktuar. Implementimi i tij ka kontribuar në ndërtimin e një mjedisi më të informuar, të vetëdijesuar dhe të sigurtë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sfidat dhe vështirësitë e hasura përgjatë implementimit, janë tejkaluar dhe nuk e kanë penguar arritjen e objektivave.


Në raport me mbërritjen e informatave dhe njohurive tek përfituesit, aktivitetet e projektit kanë rezultuar në shtrirje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Aktivitetet, ngritja e kapaciteteve dhe vetëdijësimi kanë targetuar punëtorët social nga Qendrat për Punë Sociale, stafin shëndetësor nga Qendrat e Mjekësisë Familjare, stafin e shkollave, stafin profesional nga katër QRBB, prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vetë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Të arriturat kryesore të projektit:

- Gjatë vitit të parë të projektit është realizuar **“Analiza e situatës rreth dhunës e ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara”**, e cila ka shërbyer si bazë për zhvillimin e të gjitha moduleve, prej të cilave për 5 vite radhazi përfituesit e projektit kanë marrë informata dhe njohuri që nuk i kanë pasur më parë, e po ashtu janë vetëdijesuar lidhur me situatën e dhunës dhe ndëshkimit trupor ndaj këtyre fëmijëve.
- Aspektet e lidhura me dhunën dhe ndëshkimin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, për **parandalimin, identifikimin dhe përgjigjen ndaj rasteve të dhunës**, janë ofruar gjatë gjithë projektit, përmes trajnimeve dhe sesioneve të rregullta. Këto sesione kanë trajtuar:
 - “Procedurat Standarde të Veprimit”
 - “Teknikat e Komunikimit me fëmijët me aftësi të kufizuara”
 - “Disiplinën pozitive në prindërimin e përditshëm”
 - “Parandalimin e dhunës”
 - “Stereotipet dhe paragjykimet ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara”
- Përfituesit e projektit kanë ngritur nivelin e njohurive, kapaciteteve dhe vetëdijes mbi eliminimin e dhunës dhe ndëshkimit, dhe **ndërtimin e mjediseve të sigurta për fëmijët me aftësi të kufizuara**. Modulet e trajnimeve kanë qenë në përputhje me nevojat e secilit grup të përfituesve për njohjen, identifikimin dhe përgjigjen ndaj rasteve të dhunës tek fëmijët me aftësi të kufizuara.



- Profesionistët nga mirëqenia sociale, arsimi dhe shëndetësia, kanë zhvilluar njohuritë dhe kapacitetet mbi llojet e aftësisë së kufizuar dhe teknikat e komunikimit me fëmijët me aftësi të kufizuara. Informacioni i marrë ka ndryshuar të kuptuarit më të thellë të aftësisë së kufizuar dhe qasjen praktike gjatë punës me ta. **Profesionistët** e përfshirë në ngritjen e kapaciteteve rreth komunikimit me fëmijë me aftësi të kufizuara **janë më të përgatitur në komunikimin dhe punën me fëmijë me aftësi të kufizuara.**
- Projekti ka kontribuar në dy procese të rëndësishme në nivel nacional: **rishikimin e PSV për mbrojtje nga dhuna në familje** për të integruar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara brenda këtij dokumenti, dhe **disagregimin e databazës** për identifikim të rasteve të dhunës në familje, me shtimin e një kolone ku specifikohet nëse personi (viktima, kryerësi apo dëshmitari) është me aftësi të kufizuar apo jo, për të siguruar një pasqyrë e qartë për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në dhunë në familje. Projekti ka kontribuar në promovimin e përdorimit të databazës përmes takimeve dhe shkëmbimeve të rregullta.



- Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë ngritur kapacitetet e tyre në eliminimin e dhunës dhe ndëshkimit, dhe aplikimin e metodave të disiplinës pozitive në prindërimin e përditshëm. Ata **kanë një qasje më pozitive ndaj aftësisë së kufizuar, janë më të angazhuar dhe më efikas në punën me fëmijët e tyre** por edhe më gjerë në komunitet, janë më të vetëdijshëm për pasojat e dhunës dhe ndëshkimit dhe në të njëjtën kohë kanë rritur bashkëpunimin me profesionistët në nivel lokal për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe realizimin e të drejtave të tyre për qasje në shërbimet e nevojshme.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë ngritur kapacitetet për **njohje të situatave të dhunës, largim dhe raportim të këtyre situatave**. Ata janë në proces të përgatitjes për mentorim për replikim të këtyre sesioneve me fëmijë të tjerë. Ata ndihen më të fuqizuar e të sigurtë, janë pjesëmarrës aktiv në procese brenda shkollave dhe janë kthyer në lider dhe përfaqësues të nevojave dhe kërkesave për ndërtimin e mjediseve pa dhunë për këta fëmijë.
- Ligjëratat në shkolla kanë rritur informacionin dhe vetëdijesimin e nxënësve për të **reduktuar stereotipet dhe paragjykimet** ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Grupe të ndryshme nxënësish në disa nga shkollat përfituese të projektit, kanë nisur me zbatimin e projekteve të vogla për të ndarë këto informacione me bashkëmoshatarët e tyre në shkolla.
- HANDIKOS dhe katër Qendrat e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në komunat target, kanë hartuar dhe funksionalizuar dokumentin e **Politikës për Mbrojtje të Fëmijëve** si një element themelor drejt **sigurimit të një mjedisi të sigurtë** për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo Politikë raportohet si dokument kyç në funksionimin e përditshëm. Stafit ka ngritur kapacitetet mbi njohjen, raportimin dhe reagimin ndaj abuzimeve të mundshme dhe merr trajnime të vazhdueshme për zbatim efikas të Politikës. E njëjta është shpërndarë me rrjetin prej gjithsej 15 QRBB.

”

I. HYRJE

”



HYRJE

Fëmijët në Kosovë përbëjnë rreth 30% të popullsisë. Jeta, shëndeti dhe mirëqenia e tyre ndikohen nga legjislacioni, politikat dhe puna e përbashkët e profesionistëve nga sektori publik dhe ai jo qeveritar që ofrojnë shërbime për fëmijë. Mbrojtja e të drejtave të tyre është një obligim që buron prej Kushtetutës së Republikës së Kosovës, legjislacionit vendor në fuqi e po ashtu edhe instrumenteve të ndryshme ndërkombëtare si Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës KDF.

Qeveria e Kosovës (QK) nuk ka statistika zyrtare të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë nga organizatat jo qeveritare përlogaritet që ky numër është relativisht i madh (rreth 20,000). Këta fëmijë vazhdojnë të jenë në gjendje të rëndë dhe të mos gëzojnë të drejtat e tyre themelore. Vetëm rreth 10% e tyre përfitojnë nga shërbimet e nevojshme shëndetësore, arsimore dhe sociale. Raportet e ndryshme nga OJQ-të flasin për rritje të numrit të këtyre fëmijëve që përfshihen dhe përfetojnë situata të dhunës apo ndëshkimit. Këta fëmijë vuajnë mungesën e qasjes fizike në institucionet ku ata marrin shërbimet e nevojshme për shëndetin dhe mirëqenien e tyre si institucionet shëndetësore, arsimore dhe ato të shërbimeve sociale. Barrierat fizike janë një pengesë e madhe që i përjashton ata automatikisht nga marrja e shërbimeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëqenien e tyre.

Kuadri ligjor që adreson nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara është përmirësuar. Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme dhe Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013 – 2023 synojnë të adresojnë dhe përmbushin nevojat e këtyre personave. Megjithatë LPMFFAKP mbetet ligj diskriminues pasi mbështet një numër shumë të vogël të fëmijëve me aftësi të kufizuar (ata me aftësi të kufizuar të përhershme) duke lënë jashtë skemës një numër të madh fëmijësh me aftësi të kufizuar të përkoshme e të pjesshme, të cilët kanë po ashtu shumë nevojë për përkrahje materiale për të përmbushur nevojat e tyre. Po ashtu shuma prej 100 Euro në muaj e përfituar nga ky ligj, është e pamjaftueshme për përmbushjen e nevojave të këtyre fëmijëve.

Sipas rezultateve të Indeksit për Mbrojtje të Fëmijës të publikuar nga KOMF, megjithë përpjekjet e QK për të rregulluar legjislacionin që adreson nevojat e fëmijëve me aftësi të

kufizuara, problemi kryesor mbetet zbatimi i legjislacionit në praktikë.¹ Shërbimet sociale në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara janë shumë të kufizuara dhe nuk mbulojnë nevojat reale të tyre.

Shërbimet në dispozicion për këta fëmijë, janë minimale dhe nuk përmbushin nevojat reale të tyre. Në shumë komuna këto shërbime nuk ekzistojnë duke pamundësuar punën me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe duke e lënë këtë mbështetje vetëm në diskrecion dhe mundësi të familjes. Kapacitetet njerëzore dhe financiare në dispozicion, janë larg përmbushjes së nevojës për ofrimin e shërbimeve adekuate, cilësore e të qëndrueshme për ta.

Qendrat për Punë Sociale kanë kapacitete të limituara, numër shumë të vogël të stafit, dhe nuk kanë në dispozicion shërbime të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara. Stafi komunal shëndetësor dhe arsimor, nuk i kanë trajnimet e specializuara e të nevojshme për të adresuar aftësinë e kufizuar duke bërë identifikim të hershëm të rasteve të tilla.

Shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuar në Kosovë ofrohen nga OJQ-të, ndërkohë që mbështetja shtetërore nuk është e strukturuar, nuk është e qëndrueshme dhe mbetet shumë e kufizuar e pa një qasje afatgjatë. Natyra sporadike e këtyre shërbimeve, e cila mbetet kryesisht e varur nga donatorët dhe projektet, minimizon përfshirjen e plotë të këtyre fëmijëve dhe kufizon një plan afatgjatë rehabilitimi të nevojshëm që ndihmon ata të përmbushin potencialin e tyre.

Sfidë tjetër drejt mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, mbetet dhuna dhe ndëshkimi trupor, i cili ende shihet si një formë e pranueshme e edukimit dhe disiplinimit të fëmijëve. Dhuna mund të ndodhë në çdo ambient, duke nisur prej vetë familjes, në shkolla, komunitet e shoqëri, institucione apo mjedise të tjera ku fëmija ndodhet dhe zhvillohet.

Ende nuk ka informacion të mjaftueshëm rreth fenomenit dhe raportimit të dhunës ndaj fëmijëve mes prindërve, profesionistëve dhe zyrtarëve institucional. Pasojat e dhunës janë ende të panjohura mirë në shoqërinë tonë si pasojë e mungesës së vetëdijesimit të prindërve dhe profesionistëve që punojnë me fëmijë.

¹ <https://komfkosova.org/2021/04/27/indeksi-i-mbrojtjes-se-femijes-2-0/>

Statistikat e fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët mund të jenë viktimë e dhunës apo abuzimit mungojnë në Kosovë. Për më tepër, është më e vështirë që këta fëmijë të raportojnë rastin dhe janë më shumë të ekspozuar ndaj rrezikut të përjetimit të dhunës, në krahasim me fëmijët e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuara. Sipas OBSH, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë tre deri në katër herë më shumë gjasa të jenë viktimë të dhunës se sa fëmijët e tjerë pa aftësi të kufizuara.²

Ndërkohë që sipas të dhënave të publikuara nga ASK dhe UNICEF përmes raportit të MICS 2020, 72% e fëmijëve të moshës 1-14 vjeç në Kosovë kanë përjetuar ndonjë formë të disiplinimit të dhunshëm. Në fëmijët e grupmoshës 2-14 vjeç, fëmijët me vështirësi funksionale kanë më shumë gjasa të përjetojnë format e disiplinimit të dhunshëm (82%), se sa fëmijët pa vështirësi funksionale (72%).³

Nisur nga nevoja për të rritur kapacitetet dhe koordinimin mes përfaqësuesve lokal për të njohur dhe adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e mbrojtjes, si QPS-të, QKMF-të, shkollat, dhe Qendrat Rehabilituese me Bazë në Komunitet, por edhe për të rritur vetëdijesimin e përfshirjen aktive të vetë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre në procese që i afektojnë ata, projekti ka targetuar këta akterë si përfitues kryesorë të aktiviteteve.

² https://who.int/disabili_es/violence/en/

³ <https://ask.rks-gov.net/media/5740/3-alb-mics6kos-statistical-snapshot-child-discipline->

QËLLIMI I VLERËSIMIT

Qëllimi kryesor i këtij raporti është pasqyrimi i rezultateve të arritura në mbrojtje të fëmijëve gjatë 5 viteve të implementimit të projektit “Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë”.

Raporti synon po ashtu të pasqyrojë impaktin e HANDIKOS në fushën e mbrojtjes së fëmijëve duke nxjerrë përfundimet kryesore e duke ofruar

rekomandime për qëndrueshmërinë e ndërhyrjes dhe planifikimin e iniciativave dhe aktiviteteve në të ardhmen.



Ky raport analizon tre dimensione kryesore të qëllimeve dhe implementimit të projektit:

- Vlerësimi i rezultateve – nëse aktivitetet janë implementuar sipas planifikimit dhe nëse prej tyre janë marrë rezultatet e pritura;
- Vlerësimi i ndikimit – nëse aktivitetet e implementuara kanë arritur të kenë ndikimin e parashikuar tek përfituesit.
- Vlerësimi i qëndrueshmërisë – nëse objektivat e arritura nga implementimi i projektit, kanë gjasa që të mbesin në praktikë e të mos shuhen me përfundimin e projektit;

Objektivat e vlerësimit

- Evidentimi i të gjeturave kryesore të lidhura me aktivitetet e implementuara, sfidat, impaktin e arritur tek përfituesit si dhe sukseset kryesore të projektit;
- Evidentimi i përfundimeve të dala nga vlerësimi, për të siguruar qëndrueshmërinë e të arriturave edhe pas përfundimit të implementimit të projektit;
- Ofrimi i rekomandimeve për planifikim dhe dizajnim të ndërhyrjeve në të ardhmen nga HANDIKOS dhe akerët e tjerë.

Analiza e të dhënave teorike

Janë analizuar të dhënat teorike të lidhura me projektin dhe fushën e veprimit të tij. Konkretisht është analizuar i gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ekipi i projektit dhe i lidhur me implementimin e tij, si projekt propozimi, raportet vjetore, kuadri logjik, analiza e situatës, etj.



Intervistat

Gjithsej janë **intervistuar 24 profesionistë**, zyrtarë dhe përfitues të projektit. Fillimisht është intervistuar ekipi i projektit, e më pas janë intervistuar përfituesit e projektit, zyrtarë komunal nga QPS-të, përfaqësues nga QKMF-të, shkollat, Qendrat e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi HANDIKOS, prindër dhe fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët kanë qenë përfitues të projektit.


Analiza e të dhënave të përfituara

Kombinimi i analizës teorike dhe rezultateve praktike të dala nga intervistat ka mundësuar përpunimin dhe analizën, për të bërë interpretimin e saktë të të gjeturave, përfundimeve dhe rekomandimeve në lidhje me arritjet e këtij projekti.



II. METODOLOGJIA





METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij raporti është përdorur metoda kualitative e hulumtimit. Të dhënat janë mbledhur përmes analizës teorike të projektit, raporteve vjetore, kuadrit logjik, analizës së situatës dhe dokumenteve tjera relevante, si dhe përmes hulumtimit në terren me përfituesit kryesor të projektit.

Kombinimi i analizës teorike dhe rezultateve praktike të dala nga intervistat ka mundësuar përpunimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave mbi rezultatet dhe ndikimin e intervenimeve të projektit; si dhe ka lehtësuar nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimeve në funksion të qëndrueshmërisë së këtyre intervenimeve.

Hulumtimi në terren është realizuar përmes intervistave gjysëm të strukturuar me **24 përfaqësues të ndryshëm** nga institucione të nivelit lokal, Qendrat e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi duke përfshirë edhe stafin e projektit; si dhe prindër dhe fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët kanë përfituar prej intervenimeve të projektit.

Përzgjedhja e të intervistuarve është bërë duke synuar një shpërndarje gjeografike të ekuilibruar në katër komunat e implementimit të projektit; Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë dhe Mitrovicë, si dhe duke siguruar përfaqësim të përfituesve nga secili intervenim i projektit. Më specifikisht, intervistat janë realizuar me:

- Përfaqësues të HANDIKOS
- Përfaqësues të Qendrave për Punë Sociale
- Përfaqësues të Qendrave të Mjekësisë Familjare
- Përfaqësues të rrjetit të QRBB-ve të HANDIKOS
- Prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Fëmijë me aftësi të kufizuara






Edhe une kam



III. GJETJET KRYESORE





GJETJET KRYESORE TË VLERËSIMIT

Objektivi i parë i projektit i cili është fokus i këtij raporti, është: Përmirësimi i cilësisë së politikave dhe praktikave të sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe rritja e vetëdijes dhe bashkëveprimit ndër-sektorial ndërmjet komunitetit dhe ofruesve të shërbimeve për të parandaluar dhe përgjigjur rasteve të dhunës në të gjitha mjediset në Kosovë;

Për përmbushjen e tij, aktivitetet e parashikuara kanë synuar arritjen e tre rezultateve kryesore:

- Më shumë sisteme gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve kanë zhvilluar kornizën e punës për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Prindërit dhe mësuesit posedojnë alternativa dhe përdorin aktivisht metodat e Disiplinës Pozitive dhe shmangin ndëshkimin fizik;
- Fëmijët dhe komuniteti luajnë një rol aktiv në reduktimin e dhunës në ambientet e shkollës dhe shtëpisë.

Për të arritur këto rezultate të pritshme, janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- A1:** Zhvillimi i analizës së nevojave dhe situatës rreth dhunës dhe ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- A2:** Realizimi i trajnimeve për disiplinë pozitive për prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ofrues të shërbimeve;
- A3:** Zhvillimi i sesionit informues “Specifikat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar në Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje”;
- A4:** Zhvillim i sesionit informues “Llojet e aftësisë së kufizuar dhe teknikat specifike të komunikimit me fëmijët me aftësi të kufizuar”;
- A5:** Zhvillimi i programit trajnues mbi parandalimin e dhunës për fëmijët me aftësi të kufizuar;
- A6:** Zhvillimi i modulit kundër stereotipeve dhe paragjykimeve ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset shkollore;
- A6:** Zhvillimi i dokumentit të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve.


I. Rezultatet:

Implementimi i këtij projekti, ka prodhuar rezultatet e pritura afatshkurtra dhe rezulton se i ka arritur objektivat e paracaktuara. Hartimi dhe implementimi i aktiviteteve të tij janë në përputhje të plotë dhe përkojnë me prioritetet në nivel nacional e lokal, sidomos në lidhje me përmirësimin e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Projekti rezulton në linjë me Ligjin për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Strategjinë Nacionale për Personat me Aftësi të Kufizuara.


Të gjeturat e këtij vlerësimi evidentojnë faktin se projekti ka ndikuar inicimin e dy proceseve në nivel nacional që adresojnë në mënyrë direkte dhunën ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara; Rishikimi i PSV për mbrojtje nga dhuna në familje për të integruar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe disagregimi i databazës për identifikim të rasteve të dhunës në familje, duke përfshirë numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në dhunë në familje.

Sfidë në këtë drejtim, do të mbetet vazhdimi dhe finalizimi i dy proceseve të cekura më sipër, megjithatë HANDIKOS në kuadër të iniciativave të tjera do të vijojë të punojë në partneritet me institucionet kyçe në këtë drejtim dhe do të vazhdojë mbështetjen dhe bashkëpunimin me to për të përfunduar këto procese.

Ndërhyrja ka mbështetur në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjithë akterët kyç në kontakt me fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe organizatat jo qeveritare për të influencuar ndryshimin në përmbushjen e detyrës së tyre për të krijuar një mjedis të sigurt e pa dhunë për fëmijët me aftësi të kufizuara.




Në total, nga modulet dhe sesionet e objektivës së parë të projektit, përgjatë 5 viteve implementim kanë përfituar afër **6000 persona**, nga ta ofrues të shërbimeve, prindër dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.



Ofruesit e shërbimeve kanë ngritur kapacitetet e tyre përmes moduleve dhe sesioneve të ndryshme në kuadër të projektit. Ofrimi i trajnimit për disiplinën pozitive në prindërimin e përditshëm ka zhvilluar njohuritë dhe ka ngritur kapacitetet e rreth **107 profesionistëve**. Sesioni informues mbi specifikat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në PSV për mbrojtje ndaj dhunës në familje ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për më shumë se 630 profesionistë në rritjen e njohurive dhe shkathtësive të tyre mbi nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sektorin e mbrojtjes.

Ngjashëm, moduli "Llojet e aftësisë së kufizuar dhe teknikat e komunikimit me fëmijët me aftësi të kufizuara" ka ngritur kapacitetet e mbi **760 profesionistëve** që punojnë direkt me fëmijë duke lehtësuar qasjen profesionale, rritur përgjegjësinë dhe cilësinë e punës me ta. Në funksion të sigurimit të një mjedisi të sigurt për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbi 350 ofrues të shërbimeve dhe vullnetarë të HANDIKOS kanë ngritur kapacitetet mbi njohjen, raportimin dhe reagimin ndaj abuzimeve të mundshme përmes trajnimeve të vazhdueshme për zbatim efikas të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve



Pjesa më e madhe e përfituesve në kuadër të intervenimeve të projektit duket të jenë vetë fëmijët. Moduli i trajnimit mbi parandalimin e dhunës është ndjekur nga më shumë se **260 fëmijë** të grupeve të cënueshme duke vetëdijësuar ata mbi njohjen, refuzimin dhe largimin nga situatat potencialisht të dhunshme dhe të rrezikshme për ta. Nga ana tjetër, ligjëratat me nxënës për të luftuar stereotipet dhe paragjykimet ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjedise shkollore, janë ndjekur nga rreth **3,600 nxënës** të shkollave nga katër komunat e targetuara. Këto sesione kanë ndihmuar në vetëdijësimin e tyre për të qenë pranues dhe jo paragjykes ndaj këtyre fëmijëve, duke kontribuar kështu në mjedise shkollore të sigurt dhe pa dhunë për ta.

Projekti gjithashtu ka prodhuar efektet e dëshiruara edhe në zhvillimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve të **275 prindërve** të fëmijëve me aftësi të kufizuara në prindërim përmes modulit të trajnimit për disiplinën pozitive në prindërimin e përditshëm..

II. Impakti

Projekti ka arritur të garantojë mbështetjen e nevojshme për grupet e targetuara. Informacioni dhe njohuritë e ofruara për partnerët dhe përfituesit e këtij projekti, kanë prodhuar ndryshim në mendësinë, qëndrimet dhe qasjen e tyre në punën e tyre me fëmijët me aftësi të kufizuara, ka lehtësuar raportin me këta fëmijë dhe ka rezultuar më efikas në përpjekjet e përbashkëta për të ofruar

mjedise të sigurta, pa dhunë e ndëshkim, për fëmijët me aftësi të kufizuara.



Projekti ka inicuar dhe ka mbështetur procese të rëndësishme në nivel nacional në drejtim të eliminimit të dhunës dhe ndëshkimit ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Me qëllimin për të patur të dhëna të sakta mbi fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshirë në dhunë në familje e në të njëjtën kohë për të adresuar dhe integruar në protokolet e punës së profesionistëve identifikimin, referimin dhe reagimin ndaj rasteve kur këta fëmijë janë të përfshirë në dhunë në familje, kanë nisur ndryshimet e PSV për mbrojtje nga dhuna në familje dhe databazës së disagreguar për rastet e dhunës në familje.

Bashkëpunimi mes profesionistëve në nivel lokal është rritur si pasojë e ndërveprimit aktiv me njëri tjetrin gjatë ndjekjes dhe përfshirjes në aktivitetet e projektit. Ka rritje të shkëmbimeve dhe ndarjes së informacionit mes tyre në lidhje me rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara gjë që rezulton me një qasje holistike multidisiplinare, më të përgjegjshme, më profesionale dhe më efektive në trajtimin e rasteve dhe referimin e tyre.

Sa i përket ofruesve të shërbimeve, ngritja e kapaciteteve është bërë bazuar në nevojat reale, në mënyrë të strukturuar dhe bazuar në përgjigjet e të intervistuarve ka ofruar informacione dhe njohuri shumë të nevojshme e praktike që janë integruar në punën e përditshme të këtyre profesionistëve me fëmijët me aftësi të kufizuara. Nga intervistat me përfituesit rezulton se projekti ka pasur vlerë të madhe dhe ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin profesional të tyre gjatë kontaktit me fëmijët me aftësi të kufizuara. Ngritja e kapaciteteve ka

rritur përgjegjësinë dhe vigjilencën e tyre për të identifikuar dhe reaguar në raste të dhunës ndaj këtyre fëmijëve.

Profesionistët nga QPS-të, shkollat dhe QMF-të konfirmojnë se informatat e marra nga modulet janë tashmë pjesë e praktikës së tyre të përditshme të punës dhe se ato dukshëm e kanë rritur cilësinë e punës së tyre me fëmijët me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi bazuar në intervistat e zhvilluara, këta profesionistë i klasifikojnë njohuritë e përfituara si shumë të rëndësishme për punën e tyre dhe rekomandojnë që të njëjtat të zgjerohen edhe më tej, me kolegët e tyre brenda institucioneve.

Dren Meqa, punëtor social nga Qendra për Punë Sociale Gjakovë shprehet:

“Informacionet e marra nga trajnimet i kam integruar shumë në punën time të përditshme, janë shumë të domosdoshme dhe kanë shumë efekt në punën që bëjmë”.

Ndërkohë që Albina Hoxha, edukatore në SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë shprehet:

“Këto informacione kanë qenë shumë të nevojshme pasi na kanë ndihmuar të përmirësojmë qasjen tonë jo vetëm ndaj fëmijëve me të cilët punojmë, por edhe në detyrën tonë si prindër, në familjet tona”.

Sabahate Lleshi, koordinatore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Prishtinë, thotë: ***“Puna me këta fëmijë ka sfida më të mëdha dhe për ne ka qenë e mirëseardhur***

mbështetje për të shtuar informacionin dhe kapacitetin tonë për të kontaktuar me këta fëmijë e në të njëjtën kohë për të rritur cilësinë e punës që bëjmë”.

Ndërkaq, Feride Selimi, arsimtare në Mitrovicë shprehet:

“Shpesh herë duke menduar se i ndihmojmë fëmijët, në fakt i kemi dëmtuar ata pa vetëdije. Këto module na kanë aftësuar më tej për të punuar drejt me fëmijët dhe për ti ndihmuar ata në mënyrën e duhur”.

Projekti ka prodhuar efektet e dëshiruara edhe në ngritjen e kapaciteteve të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në prindërim përmes disiplinës pozitive. Bazuar në intervistat me prindër, është përmirësuar ndjeshëm qasja e tyre ndaj fëmijëve, menaxhimi i zemërimit dhe stresit dhe raporti me fëmijët është më cilësor. Ata njëzëri i konsiderojnë kapacitetet e përfituara nga modulet si shumë të nevojshme për prindërimin e tyre të përditshëm.

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara u shprehën se tashmë dinë më shumë se si të njohin nevojat e fëmijëve të tyre dhe se si t'i trajtojnë ato në mënyrën e duhur, pa e dëmtuar fëmijën. Në të njëjtën kohë është shumë e rëndësishme të theksohet se të gjithë prindërit e intervistuar, janë

shpreshur se këto module i kanë ndihmuar ata të menaxhojnë më mirë edhe stresin e zemërimit të tyre, si pasojë e sfidave të vazhdueshme me të cilat ata ballafaqohen gjatë rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre e që është edhe një nga elementët kryesorë që mund të çojë edhe në dhunë ndaj këtyre fëmijëve.

Ajnure Dërguti, prind i fëmijës me aftësi të kufizuara në Ferizaj, ndër të tjera thotë:

“Këto trajnime jo vetëm që na kanë ndihmuar të kuptojmë më mirë fëmijët tanë dhe të dimë si të sillemi me ta, por në të njëjtën kohë na kanë ndihmuar edhe vetë ne si nëna e si prindër që të menaxhojmë më mirë stresin dhe zemërimit tonë, të jemi më të qetë përballë fëmijëve pasi tani i kuptojmë më mirë edhe nevojat e tyre”.

Të njëjtin fakt e konfirmon edhe Afërdita Gashi, prind i fëmijës me aftësi të kufizuara në Prishtinë, e cila shprehet: **“Tashmë arrij të jem më e qetë dhe ti përballoj me gjakftohtësi sfidat. E di çfarë i duhet fëmijës tim dhe nuk e bëj pjesë të shqetësimeve me të cilat ballafaqohem”.**

Impakti i projektit është i dukshëm edhe tek fëmijët me aftësi të kufizuara që kanë përfituar nga aktivitetet e tij. Bazuar në

rezultatet e hulumtimit këta fëmijë janë më të informuar e të përgatitur për të përfaqësuar me dinjitet e në mënyrë aktive të drejtat dhe nevojat e tyre karshi komunitetit dhe institucioneve të mandatuara për të punuar me ta, me fokus në fushën e mbrojtjes. Ata kanë raportuar se tani ndihen më të pranuar e të sigurtë në rrethin e tyre, i shprehin nevojat e tyre dhe janë të gatshëm që këto informata t'i replikojnë e ti ndajnë edhe më tej me bashkëmoshatarët e tyre.

Enda Rexhepi, fëmijë nga Gjakova, shprehet: **“Ligjëratat në shkollë kanë ndihmuar për të patur një ambient më të përshtatshëm. Megjithatë në shkollat e tjera situata është e njëjtë, këto ligjëratat duhet të mbahen edhe në shkollat e tjera”.**

Muhamet Ismajli, fëmijë nga Ferizaj, ndër të tjera thotë: "Mendoj që trajnimet e parandalimit të dhunës duhet të bëhen më shpesh me fëmijët, në mënyrë që të gjithë fëmijët të jenë të sigurtë".

Eldin Gashi, fëmijë nga Prishtina, shprehet: "Trajnimi ka qenë shumë i qartë dhe i kuptueshëm, këto trajnime na kanë ndihmuar shumë dhe duhet të vazhdojnë me të gjithë

Eldin Gashi, fëmijë nga Prishtina, shprehet: "Trajnimi ka qenë shumë i qartë dhe i kuptueshëm, këto trajnime na kanë ndihmuar shumë dhe duhet të vazhdojnë me të gjithë fëmijët".

Qendrat e RBB po ashtu janë fuqizuar nga projekti përmes ngritjes së kapaciteteve dhe hartimit të dokumentit të Politikës për Mbrojtje të Fëmijëve. Nga intervistimi i këtyre ofruesve rezulton se kapacitetet, bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet lokale është rritur e në të njëjtën kohë mjediset brenda organizatave janë më të sigurta për fëmijët me aftësi të kufizuara, me hyrjen në fuqi dhe aplikimin rigoroze të PMF.

Përgjatë ciklit 5 vjeçar të projektit, dy vitet e fundit u shoqëruan me implementim në kushte pandemike nga COVID19, i cili ndryshoi implementimin e aktiviteteve dhe intervenimeve të projektit. Mirëpo, pavarësisht sfidave, këto aktivitete u realizuan me disa ndryshime të cilat nuk e kanë çenuar mbarëvajtjen e tyre. Stafi ka dëshmuar përshtatshmëri ndaj situatës së krijuar nga pandemia dhe ka krijuar modalitete të reja duke zhvilluar aktivitetet në mënyrë virtuale dhe duke ofruar ndihmë e mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara por edhe familjet e tyre. Pjesëmarrja në aktivitete nga përfituesit rezulton të jetë e kënaqshme dhe bashkëpunimi me stafin e projektit ka qënë i ngushtë gjatë gjithë implementimit.

Efektet apo pasojat afatgjata të projektit ende nuk mund të maten në kohën e hartimit të këtij raporti pasi nevojitet kohë për të konstatuar nëse këto praktika do të integrohen edhe më gjerë në institucionet ku janë mbajtur aktivitetet e projektit. Po ashtu vijimësia e përdorimit dhe aplikimit të informatave të marra gjatë zbatimit të projektit, do të mbetet në vullnetin institucional të institucioneve qendrore e lokale për të çuar më tej iniciativat e nisura.

III. Qëndrueshmëria

Profili i punës së HANDIKOS është garantimi i të drejtave dhe adresimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Si rrjedhojë organizata do të vazhdojë të punojë në drejtim të mbrojtjes dhe krijimit të mjediseve të sigurta për fëmijët me aftësi të kufizuara edhe përtej përfundimit të këtij projekti.

Projekti ka kontribuar në iniciimin e rishikimit të PSV për mbrojtje nga dhuna në familje dhe të databazës së disagreguar për identifikimin e rasteve të dhunës në familje me qëllimin për të integruar në të dy dokumentet, nevojat dhe të dhënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përfundimi i këtyre dy proceseve varet nga vullneti institucional i Ministrisë së Drejtësisë e cila është edhe bartëse e të dy dokumenteve.

Megjithatë HANDIKOS bashkëpunon ngushtë me MD prej vitesh dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi dhe të kontributit të vazhdueshëm që HANDIKOS ofron, organizata do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për të përfunduar rishikimin e të dy dokumenteve.

Ky projekt përmes krijimit të moduleve për ngritje të kapaciteteve ka siguruar një aset të rëndësishëm në dispozicion, i cili mund të përdoret nga organizata apo partnerët edhe në të ardhmen për të ofruar trajnime apo sesione me grupe të interesit, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga dhuna apo ndëshkimi.

Po ashtu grupi avokues i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe grupi i fëmijëve me aftësi të kufizuara “Hana”, të cilët kanë ngritur kapacitetet e tyre për përfaqësimin dhe adresimin e të gjitha nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, janë partnerë dhe bashkëpunëtorë të rregullt të HANDIKOS. Në këtë mënyrë, gjasat janë shumë të mëdha që njohja e aftësisë së kufizuar dhe përfaqësimi i këtyre fëmijëve të vazhdojë përmes punës dhe avokimit nga fëmijët dhe prindërit e tyre.





”

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

”



Përfundim

Projekti ka arritur qëllimin e paraparë përmes objektivave dhe aktiviteteve të tij, konform afateve kohore të vendosura dhe në përputhje me burimet njerëzore dhe financiare.

Projekti ka kontribuar në dy proceset shumë të rëndësishme në nivel nacional, rishikimin e PSV për mbrojtje nga dhuna në familje për të integruar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe në disagregimin e databazës për identifikim të rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara viktime të dhunës në familje.


Përfituesit e projektit kanë ngritur kapacitetet mbi eliminimin e dhunës dhe ndëshkimit, dhe ndërtimin e mjediseve të sigurta për fëmijët me aftësi të kufizuara. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë ngritur kapacitetet e tyre në eliminimin e dhunës dhe ndëshkimit, dhe aplikimin e disiplinës pozitive në prindërimin e përditshëm. Fëmijët me aftësi të kufizuara përfitues të projektit kanë ngritur kapacitetet e tyre për njohje të situatave të dhunës, largim dhe raportim të këtyre situatave.



Sistemet zyrtare dhe joformale komunale të mbrojtjes së fëmijëve janë fuqizuar për të siguruar shërbime parandaluese, cilësore dhe të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Rekomandime:

- I. Të promovohen dhe ngriten kapacitetet e zyrtarëve në përdorimin e databazës nacionale për identifikim të rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara vitkima të dhunës në familje.
- II. Të akreditohen programet e moduleve të trajnimeve me qëllim të replikimit të modelit në komunat dhe institucionet e tjera.
- III. Të ngrihen kapacitetet e profesionistëve në komunat e tjera të Kosovës mbi “Procedurat Standarde të Veprimit”, “Teknikat e Komunikimit me fëmijët me aftësi të kufizuara”, “Disiplina pozitive në prindërimin e përditshëm”, “Parandalimi I dhunës”.
- IV. Të ngrihen kapacitetet e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunat e tjera në eliminimin e dhunës dhe ndëshkimit, dhe aplikimin e metodave të disiplinës pozitive në prindërimin e përditshëm.
- V. Të ngrihen kapacitetet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunat e tjera për njohje të situatave të dhunës dhe raportim përmes grupit avokues të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë të përgatitur të përfaqësojnë dhe avokojnë për kërkesat dhe nevojat e tyre.
- VI. Të krijohen dhe fuqizohen sistemet komunale të mbrojtjes për të siguruar shërbime cilësore dhe të qasshme.



”

V. SHTOJCAT

”



Shtojca 1

Përfituesit e përzgjedhur për vlerësim

	Emer / Mbiemer	Pozita/Institucioni	Aktivitetet	Komuna
1.	Sabahate Lleshi	Koordinatorë e QZHVP, QKMF	Sesioni “PSV” Sesioni “Teknikat e komunikimit”	Prishtinë
2.	Zana Zeqiri	Drejtoreshë, SHFMU “Meto Bajraktari”	Ligjëratat me nxënës	Prishtinë
3.	Sevdije Brahimi	Shef i shërbimeve sociale, QPS	Sesioni “PSV” Sesioni “Teknikat e komunikimit” Databaza e disagreguar	Prishtinë
4.	Aferdita Gashi	Prind	Disiplina pozitive	Prishtinë
5.	Albina Hoxha	Edukatore, SGS Fshati	Disiplina pozitive	Prishtinë
6.	Eldin Gashi	Fëmijë	Trajnimi për parandalimin e dhunës	Prishtinë
7.	Rinor Gashi	Ligjërues	Ligjeratat me nxënës	Prishtinë
8.	Ajnure Derguti	Prind	Disiplina pozitive	Ferizaj
9.	Shkodrane Hasani	Ligjëruese,	Ligjëratat me nxënës	Ferizaj
10.	Enver Kosumi	Menaxher, HANDIKOS	Të përgjithshme Politika për mbrojtjen e fëmijëve	Ferizaj
11.	Dren Meqa	Punëtor social, QPS	Sesioni “PSV” Sesioni “Teknikat e komunikimit” Databaza e disagreguar	Gjakovë
12.	Leonora Hoxha	Zyrtare për edukim formal,QKMF	Sesioni “PSV” Sesioni “Teknikat e komunikimit”	Gjakovë
13.	Brilanta Ballata	Drejtoreshë, HANDIKOS	Overall & Politika	Gjakovë
14.	Enda Rexhepi	Fëmijë	Trajnimi për parandalimin e dhunës Ligjëratat me nxënës	Gjakovë
15.	Liridona Morina	Prind	Disiplina Pozitive	Gjakovë
16.	Besa Dula	Punëtore sociale, HANDIKOS	Disiplina Pozitive	Gjakovë
17.	Lirije Segashi Behrami	Prind	Disiplina Pozitive	Mitrovicë
18.	Feride Selimi	Arsimtare, SHFMU “Shaban Idrizi”	Disiplina Pozitive	Mitrovicë
19.	Leonita Sadiku	Ligjëruese, HANDIKOS	Ligjëratat me nxënës	Mitrovicë
20.	Arta Halimi	Koordinatorë, HANDIKOS	Staf	Prishtinë
21.	Yllka Bega	Koordinatorë, HANDIKOS	Staf	Prishtinë
22.	Muhamet Ismajli	Fëmijë	Trajnimi për parandalimin e dhunës Ligjëratat me nxënës	Ferizaj
23.	Fjona Sekiraqa	Fëmijë	Trajnimi për parandalimin e dhunës Ligjëratat me nxënës	Prishtinë
24.	Enea Kadriu	Fëmijë	Trajnimi për parandalimin e dhunës Ligjëratat me nxënës	Prishtinë

Shtojca 2

PYETËSORËT

• Stafi i projektit

- 1 A mund të na bëni një përmbledhje të shkurtër të projektit dhe objektivave kryesorë të tij?
- 2 Cilat sfida keni hasur gjatë implementimit të projektit dhe si i keni adresuar ato?
- 3 A konsideroni se projekti i ka arritur qëllimet e paracaktuara?
- 4 Si e shihni qëndrueshmërinë e projektit pas përfundimit të tij?
- 5 A mendoni se projekti ka kontribuar në situatën dhe mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si e shihni këtë kontribut?

• Qendrat HANDIKOS

- 1 Si e vlerësoni në përgjithësi ndërhyrjen e projektit “Promovimi i parandalimit të dhunës në të gjitha mjediset ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë”?
JO MIRE MIRE SHUME MIRE SHKELQYESHEM
- 2 A janë rritur kapacitetet tuaja dhe stafit tuaj në parandalim, identifikim dhe përgjigje ndaj rasteve të dhunës?
PO JO MESATARISHT
- 3 Si e ka ndryshuar punën tuaj, ekzistenca dhe implementimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës?
ASPAK PAK MESATARISHT SHUME
- 3 Çfarë do të rekomandonit ju më tej për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij projekti?

• Procedurat Standarte të Veprimit PSV

- 1 A janë rritur kapacitetet tuaja për zbatim të Procedurave Standarte të Veprimit (PSV) për parandalimin e dhunës dhe llojeve të tjera të abuzimit?
PO JO
- 2 A janë rritur kapacitetet tuaja dhe stafit tuaj në parandalim, identifikim dhe përgjigje ndaj rasteve të dhunës?
PO JO MESATARISHT
- 3 Si i keni aplikuar informatat e marra nga sesioni në praktikën tuaj të punës?

PYETËSORËT

• Stafi i projektit

- 1 A mund të na bëni një përmbledhje të shkurtër të projektit dhe objektivave kryesorë të tij?
- 2 Cilat sfida keni hasur gjatë implementimit të projektit dhe si i keni adresuar ato?
- 3 A konsideroni se projekti i ka arritur qëllimet e paracaktuara?
- 4 Si e shihni qëndrueshmërinë e projektit pas përfundimit të tij?
- 5 A mendoni se projekti ka kontribuar në situatën dhe mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si e shihni këtë kontribut?

• Qendrat HANDIKOS


- 1 Si e vlerësoni në përgjithësi ndërhyrjen e projektit “Promovimi i parandalimit të dhunës në të gjitha mjediset ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë”?
JO MIRE MIRE SHUME MIRE SHKELQYESHEM
- 2 A janë rritur kapacitetet tuaja dhe stafit tuaj në parandalim, identifikim dhe përgjigje ndaj rasteve të dhunës?
PO JO MESATARISHT
- 3 Si e ka ndryshuar punën tuaj, ekzistenca dhe implementimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës?
ASPAK PAK MESATARISHT SHUME
- 3 Çfarë do të rekomandonit ju më tej për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij projekti?

• Procedurat Standarte të Veprimit PSV

- 1 A janë rritur kapacitetet tuaja për zbatim të Procedurave Standarte të Veprimit (PSV) për parandalimin e dhunës dhe llojeve të tjera të abuzimit?
PO JO
- 2 A janë rritur kapacitetet tuaja dhe stafit tuaj në parandalim, identifikim dhe përgjigje ndaj rasteve të dhunës?
PO JO MESATARISHT
- 3 Si i keni aplikuar informatat e marra nga sesioni në praktikën tuaj të punës?

• Disiplina Pozitive

- 1 A janë rritur kapacitetet tuaja në Disiplinën Pozitive gjatë prindërimit?
PO JO MESATARISHT





Sweden
Sverige



Save the Children